



#DITA BOTËRORE E FAMILJES 2019



Më 15 Maj u zhvilluan festimet për Ditën Botërore të Familjes. Në kuadër të fushatës “Ndhmo edhe ti një familje këtë 15 Maj” prezantuar 2 familje të cilat përfitonin ndihmë ekonomike dhe falë nismës së Shërbimit Social Shtetëror u punësuan në dy subjekte private. Këto raste suksesi nuk do të mbeten me kaq, thjesht kanë hapur siparin e rasteve të suksesshme që do të pasojnë.

Në Ditën Botërore të Familjes, e cila vendos në plan të parë sigurisht familjen e bashkuar e të shëndetshme, një nga fëmijët e shtëpisë sonë të madhe të Zyber Hallullit u rikthye në familje.

Mesazhin që qëndron në themel të kësaj dite dhe ndihmën që çdokush prej nesh mund t’i ofrojë një familjeje në nevojë, ne duam ta kthejmë në një traditë që do t’i qëndrojë kohës.

#SHKODËR, PRANË ÇDO QYTETARI NË NEVOJË



Shërbimi Social Shtetëror është në gadishmëri për të ndihmuar çdo qytetar që ka nevojë për ndihmë. Alfonsi nga fshati Reç, Malësi e Madhe, ka pësuar një aksident tetorin e vitit 2018. Për fat të keq prej asaj dite ai është dëmtuar dhe ka marrë statusin e personit tetraplegjik.


Shërbimi social dhe “The Door” vendosi ta ndihmojë Alfonsin duke i dhuruar një karrocë në formë motorri me anë të së cilës do mund të lëvizë lehtësisht jashtë mjedisit të shtëpisë. Fokusi jonë është t’i vijmë në ndihmë çdo qytetari duke i plotësuar nevojat që e bëjnë atë të jetojë i pavarur.



**#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK**

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kryer kontroll në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike për periudhën Mars 2018-Mars 2019. Gjithashtu është kryer kontroll në Njësinë Administrative Kallmet, Lezhë lidhur me zbatimin e legjislacionit për PAK.

Për 12 Drejtoritë Rajonale është monitoruar procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes. Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.



**#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**

Gjatë muajit Maj, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste VT/VMT dhe është koordinuar puna për pritjen e një rasti në kufi.

Komisioni për Fëmijët ka marrë vendim për sistemimin e 5 fëmijëve në institucionet e përkujdesit. Janë shqyrtuar 4 kërkesa për sistemim të PAK në institucione.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku është shqyrtuar dokumentacioni dhe kanë përfituar status 42 jetimë.

Gjatë muajit Maj Komisioni për të Moshuarit ka komisionuar 13 të moshuar për t'u sistemuar në IPSH dhe janë transferuar 3 të moshuar.





SHERBIMI SOCIAL

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Një angazhim i ri për fëmijët e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës!

Disa studentë të Qendrës së Formimit Profesional vizituan në muajin Maj Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës. Në bashkëpunim me stafin e përkushtuar të qendrës u vendos t'i jepej fëmijëve me aftësi ndryshe mundësia për të mësuar disa zanate të ndryshme me qëllim aftësimin e tyre dhe pse jo përgatitjen për t'u punësuar në sektorë të ndryshëm përmes ndërmjetësimit të Zyrës së Punës Durrës.

Ky bashkëpunim do të jetë frytdhënës për të ardhmen e këtyre fëmijëve pas largimit të tyre nga institucioni.